



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

Për: Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Znj. Donika Gërvalla - Schwarz, ministre
Ministria e Drejtësisë

Z. Elvir Azizi, drejtor
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Kopje: Z. Albert Zogaj, kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Arsim Gashi, drejtor
Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

Prishtinë, më 27 mars 2026

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në vijim: MKP) vizitoi Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (në vijim: IPFK).

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKP-ja, më 31 tetor dhe më 25 nëntor 2025, vizitoi IPFK-në.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të personave që kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik; të personave që janë subjekt i urdhrimit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor; si dhe të të burgosurve që kanë zhvilluar çrregullim mendor gjatë burgimit dhe që janë vendosur në njërin nga repartet e IPFK-së, të drejta këto që u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Përbërja e ekipit monitorues

Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- drejtoresha e MKP-së;
- këshilltari juridik për parandalim të torturës;
- këshilltarja - psikologe klinike;
- këshilltarja - punëtore sociale.

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës, bashkëpunimi i stafit shëndetësor të IPFK-së ishte korrekt. Ekipi pati qasje në të gjitha repartet që i vizitoi; u kontrolluan protokollat dhe dosjet e pacientëve, pa pengesë; ekipit iu siguruan të gjitha informacionet e nevojshme për ta kryer detyrën; si dhe iu mundësuan bisedat me pacientët, pa praninë e stafit shëndetësor dhe zyrtarëve të tjerë.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

1. Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, IPFK-ja është njësi organizative e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (në vijim: ShSKUK). Sipas ligjit në fuqi, IPFK-ja ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë)¹. Dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me IPFK-në përfshihen në Kodin Penal (nenet 18 dhe 85), në Kodin e Procedurës Penale (nenet 506 deri 518) dhe në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (nenet 169, 170, 171, 175).

¹ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, neni 13, paragrafi 1.2.

Statusi ligjor i IPFK-së

2. Lidhur me statusin ligjor të IPFK-së, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në raportin e publikuar në gusht të vitit 2018², i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë: *“Të njoftohet MKP-ja e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e statutit ligjor të IPFK-së.”* Për këtë rekomandim, IAP-ja mori përgjigje nga ShSKUK-ja: *“Çështja e statusit ligjor të pazgjidhur të IPFK-së, ka qenë në diskutim me institucionet relevante e në veçanti të MSh, me kompletimin e Ligjit për Shëndetin Mendor si dhe plotësim ndryshimin e Ligjit për Shëndetësi nuk është në kompetencë të SHSKUK-së.”* Raportin në fjalë, MKP-ja e dërgoi edhe te Ministria e Shëndetësisë, por nuk pati asnjë reagim deri më tani.
3. Lidhur me çështjen e njëjtë, në raportin e fundit të publikuar në nëntor të vitit 2022³, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë: *“Avokati i Popullit ri përsëritë rekomandimin që MKP-ja e Avokatit të Popullit të njoftohet lidhur me çështjen e statutit ligjor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.”*
4. Për rekomandimet e dhëna në nëntor të vitit 2022, IAP-ja mori përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK-ja, ku në fakt ishte e njëjta shkresë me përgjigjet e ish-drejtorit të IPFK-së, përgjigjet e të cilit nuk kishin të bënin aspak me rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit. Fokusi i ish-drejtorit të IPFK-së ishte në gjetjet e monitorimit dhe kishte kërkesa që nuk ishin në pajtim me mandatin e IAP-së⁴. Ai kërkoi që IAP-ja të ketë rregullore apo udhëzim të veçantë për monitorimin e IPFK-së. Kjo kërkesë ishte në kundërshtim edhe me nenin 30 të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili potencon: *“Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.”*
5. Për rekomandimet e dhëna në nëntor të vitit 2022 morëm përgjigje edhe nga Ministria e Drejtësisë. Kjo ministri ceku vetëm planet e trajnimeve për stafin e sigurisë, kurse për statusin ligjor nuk ka përgjigje nga asnjë autoritet relevant. Lidhur me statusin e IPFK-së, në dokumentin *Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të IPFK-së*⁵, në faqen 3 ceket: *“Statuti i institucionit do të vendoset në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Evropës.”*
6. Gjithashtu, edhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (në vijim: KPT), në raportin e fundit për Kosovën (publikuar më 23 shtator 2021⁶), potencoi se ende ekzistonte një paqartësi në lidhje me statusin ligjor të IPFK-së, gjë që, sipas përfaqësuesve të IPFK-së, e pengon ndjeshëm funksionimin e duhur dhe se ky institucion më së paku i takon ShSKUK-së. Bazuar në nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, lidhur me këtë

² Shih raportin me rekomandime për IPFK-në: <https://oik-rks.org/2018/08/28/raporti-nga-vizita-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike/>

³ Shih raportin me rekomandime për IPFK-në: <https://oik-rks.org/2022/11/30/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike/>

⁴ Neni 17 i Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

⁵ Ky dokument është hartuar me përkrahje të projektit të Këshillit të Evropës *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*, i implementuar nga Këshilli i Evropës dhe i bashkëfinancuar nga Belgjika, Gjermania, Irlanda, Norvegjia dhe Këshilli i Evropës. PSV-ja nuk është publikuar në ueb-faqe të MSh-së.

⁶ Shih raportin në <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

çështje, Avokati i Popullit do të vazhdojë të kërkojë përgjigje nga MSh-ja dhe nga institucionet e tjera relevante.

Përshkrimi i strukturës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike

7. Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilën njësi). Ekipi i MKP-së u informua se të pranishëm ishin 34 pacientë. Gjatë vizitës së fundit, ekipi u informua se filluan punimet për rritjen e kapaciteteve, gjë e cila u vërejt edhe nga ekipi monitorues i MKP-së.
8. Instituti i Psikiatrisë Forenzike (në vijim: IPFK) përbëhet nga katër njësi: Njësia A - është njësia e pranimit, ekspertimit psikiatrik ambulator, e cila kryen edhe konsultat specialistike për pacientët. Njësia B - është njësi ku zbatohen urdhëresat e gjykatave dhe të prokurorive të Kosovës për trajtim/diagnostikim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Njësia C - është njësi ku kryhet ekspertimi psikiatrik dhe trajtimi psikiatrik i të burgosurve dhe i të paraburgosurve, ku për sigurinë e këtij reparti është përgjegjës Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK). Njësia D - është njësi ku kryhet trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim me ndikim të risocializimi dhe riintegrimi i pacientëve.

Kushtet e jetesës

9. Kushtet materiale në IPFK aktualisht janë deri diku të mira. Dhomat janë me nga dy shtretër, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim. Vlen të ceket se inventari është i demoluar, ka televizor, lojëra (shahu), tavolinë të futbollit, bibliotekë të vogël me disa libra, si dhe hapësirë të përbashkët për kuzhinë. Gjatë vizitës, ekipi i MKP-së vërejt se në dhomat e pacientëve dollapët janë të demoluar. Ekipi mori informatën se ka pasur zjarr tri herë në IPFK. Sipas stafit, kjo ndodh për shkak të ventilatorëve të plastikës, të cilët janë nga materiali plastik dhe kur nxehen shkaktohet zjarr vetvetiu. Ndërsa, në dhomën e izolimit, para dy vjetësh, pacienti i hodhi ujë ventilatorit të plastikës dhe shkaktoi zjarr, i cili u menaxhua mirë nga stafi. Ekipi vizitoi dhomat e rezidentëve dhe vërejt se ato posedojnë dollapë. Në Repartin C dyshekët i sollën të rijnë nga QKUK-ja, kurse çarçafë solli ShKK-ja. Për sa u përket mjeteve higjienike, nuk qëndrojnë keq.
10. Në IPFK janë gjithsej 4 dhoma të izolimit (dy në Repartin B dhe dy në Repartin C). Gjatë kohës së vizitës, ekipi i MKP-së vërejt se kamerat nuk funksiononin, nuk kanë pasur mirëmbajtje disa vite. Sipas drejtorit, kërkesën për rregullimin e kamerave të sigurisë e drejtuan në QKUK, mirëpo nuk u bë asgjë lidhur me këtë çështje. Edhe pse filluan rritjen e kapaciteteve për dy kate, Avokati i Popullit kërkon që, përderisa ka pacientë duke u trajtuar dhe nuk dihet saktë kur përfundojnë punimet, autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin masa për t'i rregulluar kamerat e sigurisë.
11. Për sa u përket kushteve të trajtimit, në nëntor të vitit 2022, Avokati i Popullit kërkoi nga autoritetet që të rriten kapacitetet dhe të krijohen kushtet për pacientët e të dyja gjinive, si dhe për të miturit. Gjatë vizitës së fundit, ekipi i MKP-së vërejt se punimet filluan dhe ky rekomandim është në pritje për implementim. Sipas drejtorit, në projekt u parapa që të ketë pjesë të veçantë për trajtimin e gjinisë femërore, ndërsa për të mitur nuk u parapa. Në të ardhmen, MKP-ja do ta ndjekë me kujdes edhe për kategoritë që do të trajtohen në këtë institucion dhe kushtet e trajtimit të tyre.

Kontakti me botën e jashtme

12. Vizitat familjare realizohen dy herë në javë, në kohëzgjatje prej 30 minutash. Hapësirat e vizitave në të gjitha repartet janë në korridore, pa dyer, ku nuk sigurohet privatësia dhe kushtet janë të papërshtatshme, si për pacientët, ashtu edhe për familjarët e tyre. Përveç vizitave, pacientët kanë të drejtë edhe për telefonata. IPFK-ja tani (pas ndërprerjes për disa vite) ka filluar t'i praktikojë edhe vikendet terapeutike, gjë e cila u tregua e suksesshme. MKP-ja mori ankesa për sa i përket së drejtës për telefonata, pasi kjo e drejtë shfrytëzohet vetëm një herë në javë. Megjithatë, pas hetimit u konstatua se telefonatat më të shpeshta u keqpërdorën nga pacientët, pasi ata i shqetësuan edhe familjarët e tyre, si dhe telefonuan policinë me alarme të rrejshme. Kjo situatë mbetet të përcillet. Prandaj, stafi shëndetësor vendosi një rregull, sipas të cilit, secila dhomë ka të drejtë të realizojë telefonata një herë në javë, ndërsa në rast nevoje, telefonatat mund të realizohen edhe më shpesh me ndihmën e punëtorit social.

Keqtrajtimi

13. MKP-ja gjatë vizitës nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik, mirëpo nuk vërejt as shenja të dhunës fizike te pacientët. Ekipi intervistoi pacientët e pranishëm, pa praninë e stafit, të cilët pohuan se trajtohen në mënyrë të duhur nga stafi mjekësor. Gjithashtu, u vërejt një klimë pozitive ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësor.
14. Gjatë vitit 2022, kur edhe u publikua Raporti me rekomandime, MKP-ja kërkoi nga IPFK-ja që t'i kushtojë rëndësi evidentimit të incidenteve të dhunshme, përfshirë edhe përdorimin e forcës (nëse përdoret ndonjëherë), si dhe t'i regjistrojë në regjistra të veçantë incidentet dhe masën e izolimit. Megjithatë, gjatë vizitës së fundit, më 31 tetor 2025, u vërejt se ato vazhdojnë të evidentohen në një regjistër të vetëm, i cili titullohet “*Incidentet, vetëlëndimet dhe izolimet*”. Gjatë vizitës, ekipi vërejt se IPFK-ja posedon Regjistrin e aktiviteteve sociale, Regjistrin e aktiviteteve psikologjike, Regjistrin e grevës së urisë, Regjistrin e tentim-vrasjeve, Regjistrin e vdekjeve dhe vetëlëndimeve, Regjistrin për barnat e blera nga pacientët, Regjistrin e vizitave familjare, Regjistrin e biokimisë (analizave), Formularin për incidente, si dhe Regjistrin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin rrezik për vetëvrasje.

Parandalimi i vetëvrasjeve

15. Sipas pohimeve të stafit, përgjatë viteve të fundit nuk patën raste të vdekjeve apo vetëvrasjeve në IPFK. Gjatë vizitës së fundit u vërejt se IPFK-ja së fundmi përpiloi *Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin rrezik potencial për vetëvrasje; Protokollin e parandalimit dhe menaxhimit të sjelljes së çrregulluar/violente dhe Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin sjellje vetë lënduese*. Këto protokolle u verifikuan edhe nga ekipi i MKP-së.

Mjetet e kufizimit

16. MKP-ja gjatë vizitës vërejt se në IPFK përdoren një ose më shumë nga llojet e mëposhtme të kufizimit: 1. Kufizimi fizik (p.sh. çmobilizimi i një patienti duke përdorur forcën fizike – “kontrolli manual”); 2. Kufizimi kimik (d.m.th. administrimi me forcë i medikamenteve me qëllim të kontrollimit të sjelljes së pacientit); dhe 3. Izolimi (d.m.th. vendosja e pavullnetshme e një patienti vetëm në një dhomë të mbyllur). Në repart ndodhet një këmishë për fiksime mekanike, por ajo nuk u përdor asnjëherë.

17. Në IPFK janë dy dhoma izolimi në Repartin B dhe dy dhoma në Repartin C. Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti formularin e monitorimit të izolimit, ku stafi, pas monitorimit, çdo 15-30 minuta e nënshkruan formularin në fjalë. MKP-ja analizoi formularin e izolimit, të quajtur “*Forma e monitorimit të izolimit*”, në të cilin shënohen detaje, si: emri dhe mbiemri i pacientit, arsyeja e izolimit, forma e izolimit, data dhe koha e vendosjes në izolim, gjendja e pacientit, nënshkrimi i mjekut që jep urdhrin për izolim, si dhe koha dhe data e fillimit të administrimit të ilaçeve, përfshirë edhe kolonat ku shënohet koha e monitorimit. Pas përfundimit të masës së izolimit, formulari futet në dosjen e pacientit.
18. Në Repartin B, masa e izolimit evidentohet në regjistrin e quajtur “*Incidentet, vetëlëndimet dhe izolimet*”. MKP-ja vërejti se, edhe në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të IPFK-së, u përshkrua në detaje mënyra se si duhet të bëhet regjistrimi dhe raportimi i rasteve të masës së kufizimit, të cilat janë në përputhje me standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (më tej: KPT). Lidhur me masën e izolimit, MKP-ja konstatoi se në Repartin B nuk ka një protokoll specifik ku evidentohen vetëm mjetet e kufizimit, ashtu siç kërkohet sipas nenit 27, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit për Shëndetin Mendor, standardeve të KPT-së dhe PSV-së së IPFK-së. KPT-ja rikujton se përdorimi i mjeteve të kufizimit duhet të jetë subjekt i një politike gjithëpërfshirëse dhe dërgoi një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim⁷.
19. KPT-ja, në raportin e fundit për vizitën në Kosovë, lidhur me Institutin e Psikiatriisë Forenzike të Kosovës (IPFK) dhe Klinikën Psikiatrike, theksoi se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë, zakonisht e kombinuar me administrimin e detyruar të ilaçeve (me përmbajtje kimike). Gjatë vizitës së fundit të ekipit monitorues në IPFK, në tetor 2025, pas analizimit të regjistrin në të cilin evidentohen personat ndaj të cilëve u shqiptua masa e izolimit, si dhe të formularëve të pacientëve në dosjet e tyre, u vërejt se, krahasuar me vitet e kaluara, izolimi i pacientëve nuk ishte më një praktikë e shpeshtë dhe përdorej për periudha më të shkurtra kohore, zakonisht për disa orë dhe, në raste të rralla, deri në disa ditë.

Trajtimi dhe aktivitetet

20. Në IPFK, përveç vlerësimit dhe trajtimit me medikamente, kohëve të fundit filloi të funksionalizohet edhe ekipi shumëdisiplinor. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitete të tilla, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, punë dore, muziko-terapi. Gjithashtu, herë pas here ka edhe aktivitete të tjera, si: përgatitja e ushqimit së bashku me pacientët, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitoren e IPFK-së), seanca individuale dhe grupe me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore ishte i vendosur në vende të dukshme, por ky orar ishte uniform. Bazuar në vëzhgimet e ekipit monitorues, u vërejt se mungonin materialet didaktike, si: letra, ngjyra, mjete për vizatim dhe mjete të tjera për zhvillimin e aktiviteteve me pacientët. Sipas informatave të marra, QKUK-ja nuk e furnizoi mjaftueshëm dhe zakonisht materialet e nevojshme i blinte stafi i IPFK-së. MKP-ja konsideron se arti-terapia dhe puna kreative kanë një rol shumë të rëndësishëm terapeutik, rehabilitues dhe stabilizues emocional. Prandaj, inkurajon QKUK-në që ta marrë parasysh natyrën e institucionit dhe t’i furnizojë rregullisht dhe në mënyrë të mjaftueshme me mjete pune.

⁷ Shih raportin e KPT-së për vizitën e fundit në Kosovë, paragrafët 139, 140: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

21. Stafi shëndetësor u trajnuar edhe për terapi okupacionale. Mirëpo, për shkak të mungesës së mjeteve të punës dhe hapësirave adekuate, është e pamundur të realizohen aktivitete të tilla me pacientët. MKP-ja do t'i përcjellë nga afër zhvillimet e punimeve për rritjen e kapaciteteve dhe të hapësirave që planifikohen të ndërtohen për aktivitete dhe terapi okupacionale.
22. Ekipi i MKP-së vërejti se filluan të aplikohen vikendet terapeutike, për të cilat përgatitet një formular i veçantë në formë marrëveshjeje midis familjarëve, pacientit dhe stafit shëndetësor. Ky aktivitet nuk është përfshirë ende në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV). Megjithatë, ekipi shumëdisiplinor, pas çdo vlerësimi për vikend terapeutik, e njofton gjykatën kompetente. Sipas stafit, shumica e gjyqtarëve nuk i kthejnë përgjigje. Stafi vlerëson se vikendet terapeutike dhanë rezultate pozitive dhe nuk pati asnjë rast kur pacienti nuk u kthye me kohë në institucion. MKP-ja e vlerëson këtë aktivitet si pozitiv dhe inkurajon IPFK-në që, në rast mundësie, t'i rishikojë PSV-të dhe t'i përfshijë edhe vikendet terapeutike në këtë dokument.
23. MKP-ja vërejti se ekipi shumëdisiplinor përktheu dhe adaptoi për nevojat e tij dokumentin "HCR-20 V3 Rating Sheet", i cili përmban listën e 20 faktorëve historikë, klinikë dhe të menaxhimit të rrezikut, që profesionistët e përdorin për ta vlerësuar rrezikun e dhunës dhe për t'i planifikuar ndërhyrjet e nevojshme. Pas kontrollimit të disa dosjeve të pacientëve, ekipi vërejti se ky dokument dhe Plani Individual i Trajtimit ishin të përfshirë në dosjet përkatëse.

Stafi në IPFK

24. Aktualisht janë shtatë mjekë (dy prej tyre janë psikiatër forenzikë), dy specializantë të psikiatrisë forenzike, dy psikologë klinikë, dy punëtorë socialë, njëzet e dy infermierë dhe stafi mbështetës (personeli administrativ, personeli i kuzhinës, i lavanderisë, si dhe personeli i sigurimit të brendshëm).
25. Stafi mori vetëm një trajnim bazik për kapje/kontroll të menaxhimit të rasteve të vështira dhe asnjëherë tjetër nuk u realizuan trajnime të tilla për stafin. Gjatë vizitës së fundit, MKP-ja u njoftua se personeli i sigurimit ndërrohet shpesh nga kompanitë private, gjë që paraqet problem për trajnimin e tyre. Bazuar në informacionet e stafit të sigurimit, aktualisht janë vetëm dy persona nga personeli i sigurimit të brendshëm, me kohëzgjatje shërbimi katër vjet në IPFK, të cilët pohuan se para dy vjetësh morën një lloj trajnimi nga stafi shëndetësor lidhur me menaxhimin e rasteve dhe natyrën e punës së institucionit. MKP-ja inkurajon IPFK-në që për personelin shëndetësor, si dhe për personelin e sigurisë, i cili ndihmon stafin shëndetësor në menaxhimin e situatave të krizës, të realizojë në mënyrë të rregullt trajnime profesionale dhe adekuate për punën me këtë kategori pacientësh.

Rishikimi i vendimeve nga gjykatat kompetente

26. MKP-ja, ndër vite, hasi në probleme kur udhëheqësit e IPFK-së pohuan se gjykatat kompetente nuk ndryshonin masën, pavarësisht arritjes së objektivave për pacientët forenzikë. Gjatë vizitës së fundit në tetor 2025, në IPFK u vunë re ndryshime pozitive për sa i përket bashkëpunimit me gjykatat, ku, sipas drejtorit, shumica e gjyqtarëve tregojnë kujdes dhe i marrin parasysh raportet e stafit shëndetësor të IPFK-së. Disa rasteve u është ndryshuar masa e trajtimit dhe disa pacientë janë liruar. Për më tepër, pacientët forenzikë

ishin në dijëni për të drejtat e tyre procedurale dhe po marrin pjesë në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideron të nevojshme.

27. MKP-ja vëren se, edhe në raportin e fundit të KPT-së për Kosovën, u vu theksi te pëlqimi për hospitalizim dhe pëlqimi për trajtim, të cilat janë dy çështje të ndryshme. Sipas KPT-së, si parim i përgjithshëm, të gjitha kategoritë e pacientëve psikiatrikë – p.sh. vullnetarë ose jovullnetarë, të natyrës civile ose forenzike, me zotësi juridike ose me paaftësi juridike – duhet të vendosen në një pozicion ku mund të japin pëlqimin e tyre të lirë dhe të jenë të informuar për trajtim. Është aksiomatike që pëlqimi për trajtim mund të konsiderohet i lirë dhe i informuar vetëm nëse bazohet në informacione të plota, të sakta dhe të kuptueshme për gjendjen e pacientit, trajtimin e propozuar dhe efektet e mundshme anësore të tij, si dhe për mundësinë e tërheqjes së pëlqimit. Më tej, është thelbësore që të gjithë pacientët që dhanë pëlqimin e tyre për trajtim të jenë vazhdimisht të informuar për gjendjen e tyre dhe për trajtimin e aplikuar ndaj tyre, si dhe që ata të vendosen në një pozicion që ua mundëson ta tërheqin pëlqimin në çdo kohë. Përveç kësaj, çdo pacient i aftë për të gjykuar duhet ta ketë të drejtën ta refuzojë një trajtim të caktuar ose çdo ndërhyrje tjetër mjekësore. Çdo shmangie nga ky parim themelor duhet të bazohet në ligj, të lidhet vetëm me rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara qartë dhe rreptë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.
28. Për sa i përket së drejtës për trajtim, e njëjta situatë u konstatua ndër vite edhe nga Avokati i Popullit, si dhe nga KPT-ja, ku në shumicën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia për ta dhënë pëlqimin me shkrim ose e drejta për ta refuzuar trajtimin, gjendje kjo e cila vazhdon të mbetet e njëjtë.

Procedura e parashtrimit të ankesave

29. Procedura efektive për parashtrimin e ankesave është një garanci themelore kundër keqtrajtit në institucionet psikiatrike. Duhet të ekzistojnë aranzhime specifike që u mundësojnë pacientëve t'i parashtrojnë formalisht ankesat dhe të jenë në gjendje të komunikojnë me autoritetin e duhur jashtë institucionit në mënyrë konfidenciale.
30. Gjatë vizitës, MKP-ja vërejtë se në IPFK ekzistojnë kutitë e ankesave për pacientët, të cilat ishin të etiketuara siç duhet. Sipas stafit, një komision i brendshëm në IPFK, i përbërë prej tre anëtarëve, është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave. Ata pohuan se asnjëherë nuk morën ankesë. Sipas kryeinfermierit, pacientët kryesisht kanë kërkesa dhe jo ankesa. Ankesat e vetme që kishin lidhen me gjykatat, ndërkohë që ndonjëherë kishin shqetësime edhe lidhur me përdorimin e telefonit, të cilat, sipas tij, zgjidhen menjëherë. Pas përfundimit të punimeve, Avokati i Popullit do të vendosë kuti të reja të ankesave në IPFK. MKP-ja inkurajon stafin shëndetësor që pacientët të njoftohen, për aq sa është e mundur, për të drejtën dhe procedurat e parashtrimit të ankesës.

Konstatimet e Avokatit të Popullit për IPFK

- Avokatit i Popullit konstaton se ende nuk u zgjidh çështja e statusit ligjor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), edhe pse ndër vite Institucioni i Avokatit të Popullit e ngriti këtë çështje dhe e ripërsëriti rekomandimin.
- Në Repartin B të IPFK-së nuk ka protokoll specifik ku evidentohen vetëm mjetet e kufizimit, siç kërkohet në nenin 27, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit për Shëndetin

Mendor, me standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), si dhe me Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së.

- Stafi shëndetësor dhe ai i sigurimit vetëm në fillim morën një trajnim bazik për kapje/kontroll të menaxhimit të rasteve të vështira dhe asnjëherë tjetër nuk realizuan trajnime të tilla për stafin.
- Kamerat e sigurisë nuk janë funksionale.
- Stafi i sigurimit ndërrohet shpesh nga kompanitë private, gjë që po paraqet vështirësi. Ky staf rri brenda në reparte dhe shpesh e ndihmon stafin shëndetësor në menaxhimin e rasteve.
- Ka mungesë të materialeve didaktike, si: letër, ngjyra për vizatime dhe mjete të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale.
- Lidhur me kushtet e jetesës, Avokati i Popullit konstaton se filluan punimet për rritjen e kapaciteteve të IPFK-së.
- Aplikimi i vikendeve terapeutike, i cili mungoi ndër vite, nuk u përfshi në Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së.
- Lidhur me rishikimin e vendimeve nga gjykatat kompetente, ka ndryshime pozitive, ka një bashkëpunim më të mirë të gjykatave me IPFK-në dhe pjesëmarrjen e pacientëve në seancat dëgjimore kur gjykata e konsideron të nevojshme.
- Për sa i përket së drejtës për trajtim, u konstatua ndër vite nga Avokati i Popullit, si dhe nga KPT-ja, se në të shumtën e rasteve pacientëve me probleme mendore nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit, gjendje kjo që vazhdon të mbetet e njëjtë.
- Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike ekzistojnë kutitë e ankesave për pacientë, të cilat ishin të etiketuara siç duhet. Mirëpo, pacientët nuk ishin në dijeni për procedurën e ankimit me shkrim.
- Avokati i Popullit i ka të vendosura kutitë e ankesave, por ato nuk janë funksionale për shkak të dëmtimit/ndryshkut. Kutitë e reja do të vendosen pas përfundimit të rinovimeve në IPFK.

Në bazë të të gjeturave të MKP-së gjatë vizitës dhe konstatimeve të Avokatit të Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

1. *Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që ministria ta njoftojë MKP-në lidhur me çështjen e statusit ligjor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.*

Ministrisë së Shëndetësisë:

1. *Të hartohet protokoll specifik për IPFK-në lidhur përdorimin e mjeteve të kufizimit, siç kërkohet në nenin 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, me standardet e KPT-së, si dhe me Procedurat Standarde të Veprimit të IPFK-së.*

2. Të realizohen trajnime profesionale dhe adekuate për personelin shëndetësor të IPFK-së lidhur me punën me këtë kategori pacientësh. Trajnime të tilla të ketë edhe për personelin e sigurisë, i cili e ndihmon stafin mjekësor për menaxhimin e situatave të krizës.
3. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që ministria ta njoftojë MKP-në lidhur me çështjen e statusit ligjor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës.

Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës:

1. Autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin masa për t'i rregulluar kamerat e sigurisë.
2. Të gjendet zgjidhje lidhur me organizimin e sigurimit fizik, në mënyrë që stafi i sigurisë që qëndron brenda repartëve në IPFK të jetë i njëjtë, për shkak të natyrës specifike të institucionit.
3. Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës ta marrë parasysh natyrën e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës dhe ta furnizojë rregullisht dhe mjaftueshëm me mjete pune për aktivitete psiko-sociale.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

